



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data 06.06.24	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	104/02-13415-1.	

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E KAÇANIKUT • OPŠTINA KAÇANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK



Raport i Këshillit Punues rreth diskutimit publik në lidhje me Draft Statutin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut i mbajtur më datë 15.05.2024

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në komunë me theks neni 5.Zbatimi i Standarteve të Konsultimit Publik dhe Neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Njoftimi publik me kohë është përgatitë dhe është shpallur në web faqën e Komunës nga data 30 Prill 2024 deri më datë 14 Maj 2024 ku është publikuar edhe Draft Statuti i punuar nga Këshilli Punues për Funkcionalizimin e muzeut të qytetit të Kaçanikut ndërsa diskutimi publik është thirrë më datë 15 Maj 2024 nga ora 11:00 në sallën e Kuvendit Komunal.

Publikimet:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/category/konkurset-njoftimet/?page=2>

Me 15.05.2024, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e lajmi për mbajtjen e konsultimit: Njoftimi si lajm në uebfaqe:

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

Draft Statutin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut i mbajtur më datë 15.05.2024 është prezantuar me projektor si dhe, i'u është dorëzuar fizikisht, pjesëmarrësit të cilët ishin në konsultim publik, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë.

Dokumenti ka qenë në konsultim publik në webfaqën zyrtare të komunës, nga data 30.04.2024 deri më 14.05.2024, ndërsa komentet janë pranuar deri më datë 14.05.2024.

Krahas njoftimit publik ne si këshill kemi përdorë edhe metoda tjera për të i njoftuar qytetarët duke përdorur edhe rrjetet sociale dhe kontaktin e drejtpërdrejt me ta me qëllim që të kemi pjesëmarrje të konsiderueshme.

Të pranishëm në këtë diskutim publik ishin 26 pjesëmarrës ku prej tyre 11 femra e 15 meshkuj.

Kërkesat dhe përgjigjet e marra:

Laureta Vogliqi: Një sqarim në lidhje me nenin 8 pika 2 ku thotë se këshilli emërohet dhe shkarkohet nga Kuvendi Komunal e sipas mendimit tim ky këshill duhet të emërohet e shkarkohet nga Kryetari. Te përbërja e këshillit mendoj se ka qenë dashtë të jet edhe një anëtarë i shoqatës së të burgosurve politik. Gjithashtu te neni 8 pika shtatë lidhur me kompensimin e anëtarëve të këtij këshilli shuma është 100 euro ku për mendimin tim janë shumë dhe mendoj se duhet të jetë vlera 50 euro.

Xhevdet Hysa: Një nismë e mirë dhe përgëzoi këshillin punues për hartimin e këtij draft statuti dhe deri më tani nuk kam ndonjë vërejtje, ndërsa për shumën e kompensimit unë pajtohem që shuma prej 100 euro të mbetet ngase mendoj se është i arsyeshëm.

Arxhend Luzha: Në lidhje me logon e Muzeut e lexova se duhet të hapet një konkurs publik. Në këtë konkurs publik mundë të aplikojnë vetëm bizneset apo edhe individ. Mendoj se ka njerëz të vullnetit të mirë që mundë të bëjnë edhe punë vullnetare pa kompensim e në këtë rast mundë të llogaritni edhe në ndihmën time pasi që e njoh këtë lëmi.

Elmihane Malsiu-Përgëzoi këtë iniciativë por që po më intereson të dijë që objekti i muzeut a i plotëson kushtet për personat me aftësi të veçanta duke përfshirë qasjen për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

Enis Mjaki: Kjo është një iniciativë shumë e mirë dhe mos hezitoni të kërkonin ndihmë edhe nga njerëz tjerë të vullnetit të mirë që të ndihmojnë në funksionalizimin sa më të mirë të muzeut e në këtë rast unë do kisha dhënë kontributin tim në promovim dhe dixhitalizim përmes kompanisë time që e menagjoj. Më intereson të dijë se për fillim a ka buxhet për funksionalizimin e muzeut.

Floriqe Zeneli: Kam parë përbërjen e këshillit dhe pyetja ime është se në Këshillin Drejtues a mundet me qenë ndonjë student. Gjithashtu në draft statut ceket se këshilli drejtues do ti mbajë 12 takime në vit që mendoj se janë shumë dhe si do të shkoj mënyra e financimit të muzeut.

Fatos Vishi: e kam të pa qartë pjesën e përzgjedhjes së Drejtorit të muzeut. Thuhet se Drejtori zgjedhet me konkurs publik e duhet të i raportoj Këshillit Drejtues.

Pyetje dhe kërkesa me email:

Në pa mundësi që të jenë prezent në këtë diskutim publik **Kjani Sallahu** përmes e-mail-ka përshëndetur iniciativën për funksionalizimin e muzeut dhe ka dhënë një propozim në lidhje me emërtimin e muzeut. Mendoj se duhet të ndryshohet emërtimi dhe të bëhet Muzeu Historik i Kaçanikut ngase në bazë të këtij emërtimi fokusi është në qytet.

Pas diskutimit publik u mbledh këshilli punues i cili vendosi që të ndërhyj vetëm në Nenin 17 pika 4 duke e ndryshuar këtë pikë duke vendosur tekstin **MQK-ja si institucion i kulturës ka xhirollogarinë e mëvehtësishme në njërën nga bankat e licencuara të Kosovës**. Pyetjet kryesisht ishin në mënyrën se si do të funksionoj Muzeu, si dhe u dhanë sqarime rreth paqartësive lidhur me draftstatutin

Përgjigjet ndaj kërkesave:

-Këshillin drejtues e emëron dhe e shkarkon Kuvendi Komunal ngase është themeluesi i Muzeut dhe e emëron këtë këshill ndërsa Kryetari përmes DKRS e propozon te Kuvendi.

-Nga Iniciativa qytetare e tjetra nga Shoqatat e dalura nga lufta e sa i përket propozimit të juaj në iniciativën qytetare mundë të hynë edhe anëtarë të organizatave tjera por që numri është menduar 7.

-Ky është një këshill punues deri në funksionalizimin e muzeut dhe më vonë do të formohet këshilli drejtues e ne kemi menduar që të propozojmë këtë shumë dhe nëse kuvendi nuk e parasheh atëherë shuma e kompensimit mundë të ndryshoj.

-Muzeu është një institucion publik dhe duhet të ndjekën procedurat në lidhje me këtë çështje por që nuk përjashtohet mundësia që edhe në këtë formë siç e propozoni ju.

-Gjithsesi se qasje do të ketë edhe për personat me aftësi të kufizuara edhe pse vendi i muzeut është në objektin e shtëpisë së kulturës përkohësisht dhe në momentin kur të ndërtohet një objekt për muzeun atëherë do të parashihet edhe me projekt. Kjo çështje do të rregullohet edhe me rregulloren që do të bëhet së shpejti. Muzeu i Kosovës fatkeqësisht nuk ka qasje për personat me aftësi të kufizuara por ne do të mundohemi që të krijojmë këtë qasje në këtë vend ku është paraparë muzeu e në momentin kur të ndërtohet objekti i veçantë i muzeut ne me kohë do të marrim masa për qasje.

-Përmes DKRS dhe zyrës kryetarit do të mundohemi që të ndajmë buxhet dhe kjo do të bëhet në planifikimet për vitin e ardhshëm ku me siguri se muzeu do të ketë një kod buxhetor por që disa veprime që do të bëhen këtë vit e që kërkojnë mbështetje financiare ne si komunë do të bëjmë zgjidhje.

-Studentët janë pjesë e shoqërisë civile dhe besoj se në këtë këshillë është i përfshirë edhe shoqëria civile, ndërsa sa i përket numrit të takimeve në vit ne si këshill punues e kemi parë të arsyeshme që takimet të jenë 12 e nëse janë shumë atëherë edhe mundë të reduktohen varësisht prej aktiviteteve që do të ketë ky këshill.

-Këshilli Drejtues e përcjellë punën e drejtorit dhe i ndihmon në kryerjen e punëve rreth muzeut kështu që raportimi duhet të jetë edhe ndaj këshillit por edhe ndaj DKRS.

-Siç e kemi paraparë edhe në buxhet muzeu do ta ketë edhe një kod buxhetor dhe xhirollogarinë. Financat do të jenë edhe nga institucionet, por edhe nga donatorët e mundshëm.

-Të gjitha komunat e kanë kështu e poashtu neni 5 pika 1 e thekson se Muzeu shtrihet në gjithë territorin e Komunës së Kaçanikut.

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:


1. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,
2. Procesverbali
3. Lista e nënshkrimeve të zyrtarëve dhe qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik,

Raporti është përgatitur nga:

Këshilli për Funkcionalizimin e Muzeut të Kaçanikut.

Kryesues i Këshillit:

Hajredin Rramajli



Procesverbal për diskutimin publik të Draft Statutit të Muzeut të Kaçanikut

Datë: 15.05.2024

Pikat e rendit të ditës:

- 1.Fjala hyrëse nga Kryesuesi i Këshillit Punues
- 2.Fjalë përshëndetëse nga Nënkryetari i Komunës
- 3.Fjalë përshëndetëse nga Drejtoresha e DKRS
- 4.Prezentimi i Draft statutit të Muzeut
- 5.Debat i hapur

1.Fjalë hyrëse për pjesëmarrësit pat kryesuesi i këshillit punues i cili në pika të shkurta tregoi për të gjitha aktivitetet që janë ndërmarrë deri te ky diskutim publik si dhe i inkurajoi pjesëmarrësit që të të japin mendime dhe sugjerime rreth këtij draft dokumenti.Ai gjithashtu prezantoi edhe Këshillin Punues për funksionalizimin e Muzeut në përbërje:

-Hajredin Rramajli- Jurist dhe Arkeolog-Kryesues i këshillit

-Sevdije Shehu-Historiane

-Ermira Krasniqi-Arkeologe

-Xhabir Zharku-Kryetarë i OVL-UÇK

-Ilaz Krasniqi-Historian-OVL-UÇK

-Shefket Palloshi-kameraman-OVL-UÇK

-Fatmir Qaka-Zyrtarë nga DKRS

-Procesmbajtës caktoi Fatmir Qakën,për prezentim Ilaz Krasniqin dhe Ermira Krasniqin ndërsa për foto e inqizim Shefket Palloshin

2.Kët aktivitet e përshëndeti edhe Nënkryetari i Komunës z.Sabedin Vishi i cili falënderoi të pranishmit për pjesmarrje në kët diskutim publik si dhe falënderoi Këshillin Punes për angazhimin e tyre në hartimin e këtij draft statuti shumë të rëndësishëm për komunën tonë.

3. Drejtoresha e DKRS falënderoi pjesëmarrësit dhe i njoftoi ata për hapat që janë marrë deri më tani lidhur me qështjen e Muzeut.Ishte një kërkesë nga një iniciativë qytetare dhe nga Shoqatat e dalura nga lufta e UÇK-së drejtuar Kryetarit të komunës ku më pas Kryetari përmes DKRS ju ka drejtuar Kuvendit Komunal dhe më datë 29.09.2022 kuvendi mori vendim për themelimin e Muzeut.Më pas më datë 31.01.2024 kuvendi komunal me një vendim emëroi këshillin punues prej 7 anëtarëve për funksionalizimin e muzeut.

Ky këshill punues pas disa takimeve dhe vizitave të ndryshme që ua janë bërë disa muzeve ka arritë ta bëjë një draft statut të cilin e keni para jush dhe sipas procedurave ligjore për diskutim publik ky document ka qenë i shpallur që nga data 30 prill i këtij viti në ëeb faqën e

komunës. Shfrytëzoj rastin të falënderoj edhe këshillin punues për kontributin e dhënë në hartimin e këtij dokumenti. Pres nga ju që të kemi një debat të mirfilltë me qëllim që ky dokument të shkojë në kuvend komunal për miratim.

4. Prezentimin me videoprojektor të draft statutit të muzeut e bënë Ilaz Krasniqi dhe Ermira Krasniqi si anëtarë të këshillit punues.

5. Pas prezantimit të draft statutit u hap diskutim publik me pjesëmarrësit.

Laureta Vogliqi: dua një sqarim në lidhje me nenin 8 pika 2 ku thotë se këshilli emërohet dhe shkarkohet nga Kuvendi Komunal e sipas mendimit tim ky këshill duhet të emërohet e shkarkohet nga Kryetari.

Hajredin Rramajli: Këshillin drejtues e emëron dhe e shkarkon Kuvendi Komunal ngase është themeluesi i Muzeut dhe e emëron këtë këshill ndërsa Kryetari përmes DKRS e propozon te Kuvendi

Laureta Vogliqi: te përbërja e këshillit mendoj se ka qenë dashtë të jetë edhe një anëtarë i shoqatës së të burgosurve politik.

Hafize Sallahu: kan qenë dy kërkesa që kan ardh për themelimin e Muzeut. Njëra ka qenë nga Iniciativa qytetare e tjetra nga Shoqatat e dalura nga lufta e UQK-së e sa i përket propozimit të juaj në iniciativën qytetare mundë të hynë edhe anëtarë të organizatave tjera por që numri është 7.

Laureta Vogliqi: gjithashtu te neni 8 pika shtatë lidhur me kompenzimin e anëtarëve të këtij këshilli shuma është 100 euro ku për mendimin tim janë shumë dhe mendoj se duhet të jetë vlera 50 euro.

Hajredin Rramajli: ky është një këshill punues deri në funksionalizimin e muzeut dhe më vonë do të formohet këshilli drejtues e ne kemi menduar që të propozojmë këtë shumë dhe nëse kuvendi nuk e parasheh atëherë shuma e kompenzimit mundë të ndryshoj.

Xhevdet Hysa: është një nismë e mirë dhe përgëzoj këshillin punues për hartimin e këtij draft statute dhe deri më tani nuk kam ndonjë vërejtje ndërsa për shumën e kompenzimit unë pajtohem që shuma prej 100 euro të mbetet ngase mendoj se është i arsyeshëm.

Arxhend Luzha: në lidhje me logon e Muzeut e lexova se duhet të hapet një konkurs public. Në këtë konkurs public mundë të aplikojnë vetëm bizneset apo edhe individ. Mendoj se ka njerz të vullnetit të mirë që mundë të bëjnë edhe punë vullnetare pa kompenzim e në këtë rast mundë të llogaritni edhe në ndihmën time pasi që e njoh këtë lëmi.

Hajredin Rramajli: muzeu është një institucion public dhe duhet të ndjekin procedurat në lidhje me këtë qështje por që nuk përjashtohet mundësia që edhe në këtë formë siq e propozoni ju.

Elmihane Malsiu: përgëzoj këtë iniciativë por që po më intereson të dijë që objekti i muzeut a i plotson kushtet për personat me aftësi të veqanta duke përfshirë qasjen për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

Hajredin Rramajli: gjithsesi se qasje do të ketë edhe për personat me aftësi të kufizuara edhe pse vendi i muzeut është në objektin e shtëpisë së kulturës perkohsisht dhe në momentin kur të ndërtohet një objekt për muzeun atëherë do të parashihet edhe me projekt.

Ermira Krasniqi: Muzeu i Kosovës fatkeqsisht nuk ka qasje për personat me aftësi të kufizuara por ne do të mundohemi që të krijojmë këtë qasje në këtë vend ku është paraparë muzeu e në momentin kur të ndërtohet objekti i veçant i muzeut ne me kohë do të marrim masa për qasje.

Enis Mjaki: është një iniciativë shumë e mirë dhe mos hezitoni të kërkonit ndihmë edhe nga njerëz tjerë të vullnetit të mirë që të ndihmojnë në funksionalizimin sa më të mirë të muzeut e në këtë rast unë do kisha dhënë kontributin tim në promovim dhe dixhitalizim përmes kompanisë time që e menagjoj. Më intereson të dijë se për fillim a ka buxhet për funksionalizimin e muzeut.

Hafize Sallahu: përmes DKRS dhe zyrës kryetarit do të mundohemi që të ndajmë buxhet dhe kjo do të bëhet në planifikimet për vitin e ardhshëm ku me siguri se muzeu do të ketë një kod buxhetor por që disa veprime që do të bëhen këtë vit e që kërkojnë mbështetje financiare ne si komunë do të bëjmë zgjidhje.

Florije Zeneli: kam parë përbërjen e këshillit dhe pyetja ime është se në këshillin Drejtues a mundet me qenë ndonjë student. Gjithashtu në draft statut ceket se këshilli drejtues do ti mbajë 12 takime në vit që mendoj se janë shumë.

Hajredin Rramajli: studentët janë pjesë e shoqërisë civile dhe besoj se në këtë këshillë është i përfshirë edhe shoqëria civile, ndërsa sa i përket numrit të takimeve në vit ne si këshill punues e kemi parë të arsyshme që takimet të jenë 12 e nëse janë shumë atëherë edhe mund të reduktohen.

Laureta Vogliqi: pjesë e këshillit drejtues mundë të jenë edhe artistë pasi që edhe vet muzeu është një art.

Ermira Krasniqi: në këshillin punues që jam pjesë e sajë mua më kanë ftuar si arkeologe dhe unë i jam përgjigjur kësaj ftese.

Fatos Vishi: e kam të pa kuartë pjesën e përzgjedhjes së Drejtorit të muzeut. Thuhet se Drejtori zgjedhet me konkurs publik e duhet të i raportoj Këshillit Drejtues.

Hajredin Ramajli: Këshilli Drejtues e përcjellë punën e drejtorit dhe i ndihmon në kryerjen e punëve rreth muzeut kështu që raportimi duhet të jetë edhe ndaj këshillit por edhe ndaj DKRS.

Florije Zeneli: si do të shkoj mënyra e financimit të muzeut.


Hajredin Rramajli: Siq e kemi paraparë edhe në buxhet muzeu do ta ketë edhe një kod buxhetor dhe xhirollogarinë. Financat do të jenë edhe nga institucionet por edhe nga donatorët e mundshëm.

Në pa mundësi që të jenë present në këtë diskutim publik Kiani Sallahu përmes e-mail-ka përshëndetur iniciativën për funksionalizimin e muzeut dhe ka dhënë një propozim në lidhje me emërtimin e muzeut. Mendoj se duhet të ndryshohet emërtimi dhe të bëhet Muzeu Historik i Kaçanikut ngase në bazë të këtij emërtimi fokusi është në qytet.

Hajredin Rramajli: Të gjitha komunat e kanë kështu e poashtu neni 5 pika 1 e thekson se Muzeu shtrihet në gjithë territorin e Komunës së Kaçanikut .

Për afro dy orë zgjati diskutimi publik dhe të gjithë u ndanë të kënaqur me sqarimet që ju bënë grupi punues i këtij diskutimi publik

Kryesoi: Hajredin Rramajli



Procesmbajtës: Fatmir Qaka



Aktiviteti: Konsultim publik-Darft Statuti i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut(MQK)

Datë:15.05.2024

Vendi:Salla e Kuvendit Komunal-Kaçanik

Emri e Mbiemri	Përfaqësimi	Kontakti	Nënshkrimi
Fatmir Qaka	DKRS	044-346-157 fatmirqaka@gmail.com	
Elmihamë Malsiu	Handikos	044 235 717 handikoskoga@gmail.com	
Shëfije Bafiri	Hondikos		
Kulthana Luma		kulthana.luma@abs-gov.net	
Muhammed Fera		muhammed.fera@abs-gov.net	
Emona Deda	NGO-CMA	044 892 690	
Laureta Veqelipi	NGO-CMA	049 263 048	
Agjond Lusha	zyrtar	013 505 985	
DIANA LUZHA	Qta Group / Shoqni Civile	048 417 282	
ASTRIT SOKOL	MIM DENT	044-280-163	
Enis Mjaka	SHIGJETA	046-192-921	
Vakon Mjaki	KVRL	049-695-931	
Aubona Çaka	KVRL	049-519-237	
Ditjona Çaka	KVRL	043-880-817	
Gazmend Luzha		044-161 730	
Ismail Murseli	DKRS	045-217-411	
JAÇO DIBI	DKRS	044-253-011	
Lulzim Shehu		049/924-120	
MEHMET HYSA	DREJTOR SHËNJA "AGIM BAJRAMI"	044-462-078	
VERA DEMA	KNDPS-2001	044279 386	

[illegible]



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAÇANIKUT • OPSTINA KAÇANIK • MUNICIPALITY OF KAÇANIK



09Nr. - 104/02-104R3/24

Kaçanik, 07.05.2024

Komuna e Kaçanikut përmes Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, lëshon këtë:

Ftesë për Konsultim Publik

Lidhur me Draft Statutin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.

Ky dokument do të jetë në diskutim publik në web faqën e komunës së Kaçanikut nga data 30.04.2024 deri më datë 14.05.2024 ndërsa konsultimi publik do të mbahet më 15.05.2024 në sallën e Kuvendit Komunal, në objektin e administratës komunale, duke filluar nga ora 11:00.

Komentet dhe sugjerimet e juaja mund të i dërgoni deri më datë 14.05.2024, ora 16:00, tek zyrtari i DKRS Fatmir Qaka, fatmir.caka@rks-gov.net

Draft Statutin e Muzeut të Kaçanikut mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm:

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2024/04/draft.pdf>

